



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
AGJENCIA E MBROJTJES SË KONSUMATORIT

Nr. _____ Prot.
____/____/2018

Tiranë, _____ më

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Data: 01/08/2018

Nga: Autoriteti Kontraktor Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit
Adresa: Rr. "Abdi Toptani", Tiranë

Për: "KASTRATI" sh.p.k. me Nr. NIPTI J61813529P
Adresa: Lagja 14, Rruga "Tirana", pranë Gjykatës së Apelit, Shkozë, Durrës

Procedura e prokurimit: "Blerje karburant gazoil për automjetet e Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit", me mjete elektronike.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-78527-07-09-2018

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Blerje karburant gazoil për automjetet e Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, me kohëzgjatje kontrate deri me 31.12.2018.

Fondi limit total: 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: Financim nga Bashkia Tiranë në mbështetje të Vendimit Nr.132 datë 21.12.2017 të Këshillit Bashkiak të Tiranës për "Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2018".

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 23.07.2018

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë **“A&T” sh.a.** me Nr. NIPTI: L32320008H, me operatorin ekonomik **“OLSI” sh.p.k.** me Nr. NIPTI: K32528408H kanë paraqitur ofertën ekonomike me marzh fitimi 8.8 %.
2. **“KASTRATI” sh.p.k.** me Nr. NIPTI: J61813529P, ka paraqitur ofertën ekonomike me marzh fitimi 13.4%.

Është skualifikuar ofertuesi i mëposhtëm:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë **“A&T” sh.a.** me Nr. NIPTI: L32320008H, me operatorin ekonomik **“OLSI” sh.p.k.** me Nr. NIPTI: K32528408H.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë **“A&T” sh.a.** me operatorin ekonomik **“OLSI” sh.p.k.**, është konstatuar se:
 - Referuar pikës 2, neni 74 **“Bashkimi i operatorëve ekonomikë”** të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 **“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”** i ndryshuar citohet se: **“Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës.** Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi”. Nga operatori ekonomik **“A&T” sh.a.** është paraqitur kontrata e bashkëpunimit Nr.1176 Rep., Nr.309 Kol., datë 11/05/2018. Në kontratë nuk janë përcaktuar përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së furnizimit që do kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Nuk është dorëzuar prokura e posaçme.

- Referuar pikës 3, neni 74 ***“Bashkimi i operatorëve ekonomikë”*** të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 ***“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*** i ndryshuar citohet se: ***“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.*** Nuk janë dorëzuar dokumentat për operatorin ekonomik “OLSI” sh.p.k.
- Nuk është paraqitur Fletë Analiza e lëshuar nga ISHTI për operatorin ekonomik “A&T” sh.a.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “KASTRATI” sh.p.k. me Nr. NIPTI: J61813529P, Adresa: Lagja 14, Rruga “Tirana”, pranë Gjykatës së Apelit, Shkozë, Durrës, se oferta e paraqitur me një me marzh fitimi 13.4%, është identifikuar si oferta më e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, Rr. “Abdi Toptani” Tiranë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi. Së bashku me sigurimin e kontratës duhet të sillni të gjithë dokumentacionin e paraqitur në tender (origjinal ose fotokopje e noterizuar), i cili verifikohet nga KVO dhe bëhet pjesë e dosjes së tenderit.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, procedura e prokurimit do të anulohet për mungesë konkurrence, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit Nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 24.07.2018

Ankesa: Jo

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Rudina Hoxha